

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: Shkolla Babe Dude Karbunara

Fuqia e kerkuar 102kW

Fuqia e instaluar 147 kW

Punoi:

ING.Fatmir Ndreka

ING.Elisa Rec

ING.Arjan Coka

Arjan
Coka

Digitally signed by Arjan Coka
DN: c=AL, l=Tirane, o=Person
Fizik, title=Inxhinier Elektrik,
cn=Arjan Coka
Date: 2020.03.11 19:50:36
+01'00'

SISTEMI ELEKTRIK

- 1. Te dhenat e objektit**
- 2. Furnizimi me energji elektrike i objektit ne TU**
- 3. Rrjeti i kablllove dhe percjellesave te tensionit te ulet**
- 4. Panelet elektrike te TU te shperndarjes**
- 5. Nenshperndarja ne tension te ulet**
- 6. Instalimi i ndricimit dhe prizave te sherbimit**
- 7. Sistemi i telefonise, TV dhe Sinjaleve**
- 8. Nricimi emergjent**
- 9. Sistemi i detektimit te zjarrit**
- 10. Sistemi i tokezimit dhe i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike**

1.1 Te dhenat e objektit.

Ojekti eshte Shkolle. Projekti elektrik duhet te respektoje te gjitha konditat projektuese dhe standardet qe janë sot ne fuqi ne Shqipëri dhe për elemente speciale qe nuk parashikohen ne këto standarde duhet ti referohemi euro normes (EN), dhe euro standardeve (EN, ED) dhe te rekomandimeve te CEI, CENELC, DIN, VDI/VDE. Ne këtë projekt janë parashikuar materiale dhe pajisje te prodhuara ne vendet e BE mbas vitit 2000.

Këto kërkesa te përgjithshme do te plotësohen sikurse janë treguar ne skicat dhe projektet si dhe përshkrimeve apo instruksionet te projektit

1.2 Furnizimi me energji elektrike i objektit

Furnizimi me energji elektrike do te behet nga kabina elektrike e ekzistuese te rrjetit te shperndarjes. Linjat e furnizimit vjen nga rrjeti publik ne panelin e matjes, furnizimi dhe matja e enrgjise elektrike do behet i ndare per secilin seksion sipas shfytzimit.

Lista e konsumatoreve dhe te dhenat baze te tyre.

Fuqia e instaluar e ndriçimit: $P=25\text{KW}$

Fuqia e instaluar e paisjeve te sallave te laboratoreve : $P=72\text{KW}$

Fuqia e instaluar paisje kondicionimi $P=12\text{KW}$

Fuqia e instaluar pompa kaldaja $P=13\text{KW}$

Fuqia e instaluar pompa dhe uji i ngrohje: $P=25\text{KW}$

Fuqia totale $P_{\text{total}} = 147$

Koefiqenti i fuqise: $\cos\varphi=0.83$

Koeficienti i njekoshmerise: 0.65

Fuqia aktive e kerkuar: $P_{\text{total}} * 0.7 = 147 * 0.7 = 102\text{kW}$

Per te gjitha linjat kryesore te furnizimit percjellsi i neutrit kombinohet me percjellsin e mbrojtjes se tokezimit (sistemi TNC).

1.3 Rrjeti i kablllove te tensionit te ulet

Kabllo e tensionit te ulet qe do te perdoren rekomandohen te jene te tipit FG7OR ose FROR, sipas standarteve CEI 20-13 IEC 60502-1 CEI UNEL 35375-35377 CEI 20-22 II CEI EN 60332-1-2 CEI EN 50267-2-1. Paneli kryesor i secilit seksion do te furnizohet me kabell 4x95mm² per distance jo me te madhe se 50ml, ne te kundert te behen edhe njehere llogaritjet ne varesi te distances..

Nga ky paneli kryesor ne katin 0 PK do te furnizohet dhe energji dhe panelet respective te kateve me siper. Ne secilin kat do te kete dy panele shperndarje percek ne katin -1. Ne fundet e cdo kablli duhet do te instalohen terminalet e kablllove te presuar, gjithashtu te behet edhe etikimi i tyre. Linjat dalese nga kuadri kryesor i shperndarjes ne tensioni te ulet do te mbrohen kunder mbingarkeses dhe qarkut te shkurter nepermjet automateve. Ne cdo fund te kabllit duhet te instalohen terminalet dhe te presohen. Kabllot do te shtrihen ne tuba korrugat nen suva ose dysHEME. Gjate instalimit te kablllove, nuk duhet te ushtrohet tension fizik apo terheqje tek terminali apo tek pjeset e tjera por, duhet te fashetohen ne menyre qe peshen e ti ta mbaje fasheta. Percjellesit e tensionit te ulet do te shtrihen brenda tubit fleksibel nen suva dhe nen shtresa. Secili nga percjellesit, ai i fazes, neutrit dhe tokezimit duhet te kene te njejtin seksion. Ne cdo rast percjellesit dhe kabllot duhet te lihen rezerve ne te dy ekstremet me qellimin per te manovruar lehtesisht me to.

Linjat elektrike per furnizimin e paneleve ne kate do te behet nepermjet kolones ku Jane vendosur tubacionet paraprakisht.

1.4 Paneli elektrik i TU i shperndarjes

Panelet e shperndarjes ne kate do te jene plastik brenda murit deri n e72 module, ne te kundert duhet te behen metalik jasht murit. Poshte tyre do te instalohet kutia plastike e derivacionit PT7. Tensioni nominal 230VAC. Pjesa brenda e panelit do të jenë të mbrojtura absolutisht nga kontaktet e paqëllimshme me pjesë të cilat janë nën tension normalisht (zbara, terminalet, paisjet, etj) duke i mbuluar pjeset e ekspozuar rryme percuese.

Cdo automat dhe paisje ne panel duhe te jete e emertuar me etiketa perkatese seipas destinacionit apo paisjes qe mbron.

Do te perdoren standartet e meposhteme per panelin dhe paisjet e mbrotjes brenda tij:

IEC 60439, IEC 60947-2, EN 60947-2, IEC 60947-2, EN 60947-2, EN41140



Panel brenda murit

- *Tensioni nominal i shfrytezimit U_e 690 V*
- *Tensioni nominal i izolimit U_i 1000 V*
- *Rryma nominale I_n 125 A*
- *Shkalla e mbrojtjes IP41*
- *Materiali: Termoplastik*
- *Porte transparente*

1.5 Nenshperndarja ne tension te ulet

Sipas skemave dhe vizatimeve kuadrot e nenshperndarjes per ndricimin e koridoreve, sallave, zyrave, dhomave etj.

Ne perputhje me vizatimet, rregullat e meposhtme te shperndarjes jane rene dakord: Cdo kuti nenshperndarese ka nje celes hyres (nderpreres ngarkese) ose nderpreres ngarkese me sigures. Cdo kuader nenshperndares eshte i pajisur me nderpreres te mbitensionit te tipit C per cdo faze (siguresat para tij) dhe indikatore te fazes (siguresat para tij).

Grupet e MCBs (miniautomatet e qarqeve) kane nje RCD (rele diferenciale) ne krye te tyre.

Cdonjera prej MCBve jane pajisje me 3pole+N ose 1pole+N

Cdonjeri prej RCDve jane pajisje me 4 pole

Pajisjet e kombinuara RCD MCB jane pajisje me 2pole

Cdo RCD per ndricim, per pajisje te tjera te lidhura direkt dhe per priza te mbrojtura me te medha se 25A, ka rryme vepruese prej 100mA dhe eshte normalisht pajisje e Tipit AC (rryma nominale 40A).

Cdo RCD per prizat me rryme te barabarte ose me te ulet se 25A ka rryme vepruese prej 30mA dhe eshte tipit normal A (rryma nominale 40A)

Maksimumi i 6 MCB 1pole+N lidhet ne 1 RCD me 4pole.

Maksimumi i 18 tubave ndricues lidhet ne 1 MCB 1pole+N

Maksimumi i 5 fan Coilave lidhet ne 1 MCB 1pole+N

Cdo pajisje me fuqi me te larte se 1,5kW ka nje MCB te vecante. Udhezimet e mesiperme nuk jane strikte dhe ndryshime te vogla pranohen (gjithmone me vizatim dhe bazuar kushtit teknik dhe se teres, ne menyre qe funksionaliteti i kerkuar te realizohet).

Ndricimi i pergjithshem i shkalleve do te komandohet me ane celesave se shkalleve. Keto kontrolle do te mbirregullohet nga ana e nje celes kryesor (automatik /on) ne kuadrin e shperndarjes.

Gjithe percjellsat e te gjithe kabllave dalese duhet te lidhen ne terminale.

Specifikimet e kabllave, kanalinave dhe tubave jane si meposhte:




Percjelles N07V-K

- *Tensioni nominal U_0 450V*
- *Tensioni nominal U 750V*
- *Tension prove 3000V*
- *Tensioni maksimal 1000V*
- *Temperatura max e perdorimit 70°C*
- *Temperatura minimale e operimit (pa ushtruar goditje) -10°C*
- *Qendrueshmeria mekanike 50N/mm²*
- *Spesori i izolimit 0.7-1mm i tipit PVC*



Kabell FG7OR

- *Tensioni nominal U_0 600V*
- *Tensioni nominal U 1000V*
- *Tension prove 4000V*
- *Tensioni maksimal 1200V*
- *Temperatura max e perdorimit 90°C*
- *Temperatura minimale e operimit (pa ushtruar goditje) -15°C*
- *Qendrueshmeria mekanike 50N/mm²*
- *Spesori i izolimit 0.7-1.7mm i tipit PVC*



Kutiat shperndarese brenda murit

- *Materiali: Teknopolimer anti vandal me baze ABS*
- *Rezistenca ndaj goditjeve: 6j*
- *Tensioni maksimal 1200V*
- *Temperatura e operimit: -5 - 60°C*
- *Standarti: CEI 23-48 ED. 1995, IEC 670 ED*

1.6 Instalimi i ndricimit dhe prizave te sherbimit

Ne cdo dhome do te kete ndricim normal ne perputhje me standartin EN 1838.
Minimumi mesatar i ndricimit Em / indikatori ngjyres Ra / lartesi te planit referues:

Korridor: 100 Lux / 40 / 0,00m

Shkallet: 150 Lux / 40 / 0,85m

Tualetet, dushet: 200 Lux / 80 / 0,85m

Sallat: 250 Lux / 80 / 0,85m

Kuzhina: 500 Lux / 80 / 0,85m

Dhoma gjumi private: 300 Lux / 80 / 0,85m

Ndricimi do te jete LED me shkalle mbrojtje ne varesi te ambjentit ku do te vendoset.

Furnizimi i ndricuesve do te behet me kabell FROR 3x1.5mm² ose me percjelles N07V-K 3x1.5mm² brenda tubit plastic fleksibel.

Prizat e sherbimit

Cdo dhome do te kete prize sherbimi nje fazore, 16A 220V te cilat do te instalohen ne kutite brenda murit. Keto priza do te furnizohen me percjelles N07V-K 3x2.5mm² brenda tubit fleksibel te series se rende.

Prizat do te mbrohen me automat te tipit C16 2 polar, si edhe me automat diferencial 30mA. Cdo prize do te kete percjellesin e mbrojtjes me te njejtin seksion sa ai i fazes dhe neutrit.

Pas instastalimit te percjellesave brenda tubit fleksibel, brenda tubit duhet te kete nje hapsire boshe min 30%.

Vizatimet jane dhe per cdo panel shperndares

1.7 Ndricimi i brendshem i emergjences

Ndricimi i daljes dhe ai i emergjences duhet te behet ne perputhje me EN1838.

Ndricuesit e daljes dhe ato te emergjences jane te instaluar ne siperfaqe, min. 1x11W, me bateri te brendshme (autonomia minimale 1 ore, maksimumi i kohes se karikimit 12 ore) dhe paisje elektronike.

Ndricuesit e daljes jane gjithmone te ndezur dhe jane te paisur me nje shenje te gjelber (shenja paraqet nje njeri me nje shigjete dhe nje dere ne drejtimin qe duhet te largohen njerezit)

Ndricuesit e emergjences jane gjithmone te ndezur.

Te kuadrot nenshperrndarese duhet te vendoset nje paisje testuese me nje reset te vonuar te rregullueshem (ca. 5 - 45 minuta).

Ndricimi i brendshem i emergjences

Ndricimi i daljes dhe ai i emergjences duhet te behet ne perputhje me EN1838.



Ndricues emergjent

- *Tensioni Nominal: 220V*
- *Autonomia: 1 ore*
- *Fluksi i ndricimit: 150lm*
- *Fuqia: 11W*
- *Shkalla e mbrojtjes: IP40*

- *Materiali: Polikarbonat.*

Ndricuesit e daljes (exite) jane gjithmone te ndezur dhe jane te paisur me nje shenje te gjelber (shenja paraqet nje njeri me nje shigjete dhe nje dere ne drejtimin qe duhet te largohen njerezit).



Specifikimet teknike jane si meposhte:

- *Tensioni Nominal: 220V*
- *Autonomia (ne rast nderprerje energjie): 1 ore*
- *Fluksi i ndricimit: 150lm*
- *Fuqia: 11W*
- *Shkalla e mbrojtjes: IP40*
- *Materiali: Polikarbonat*
- *Distanca e dukshmerise: 15m*

1.8 Sistemi i telefonise, tv dhe LAN

Sistemi i rrjetit telefonik dhe komunikimit i te dhenave

Kontraktori duhet te instaloje nje sistem rrjeti telefonik me tela dhe kuti shpendarese ne menyre qe te krijoje nje komunikim telefonik nepermjet telave nga burimi i linjes. Ne bashkepunim me distributorin duhet te beje te mundur furnizimin me sinjal telefonik dhe te internetit. Linjat do te jene UTPcat6 ne menyre qe te kete edhe fije rezerve. Te gjitha linjat ne kate perfundojne ne Rack ne katin perdhe, nepermjet shaftit. Te gjitha duhet te emertohen. Ne objekt sipas vizatimeve do te kete shperndarje WiFi nepermjet acces point dhe prizave sipas vizatimeve.

Sistemi TV do te jete i shperndare npermjet derivatoreve dhe partitoreve. Shperndaresit duhet te jene brenda kutive dhe te mbrojtur nga lageshira. Jane dy mundesi per shperndarjen e sinjalit Tv sipas skemave te vizatimeve. Te diskutohet me investitorin.

1.9 Sistemi i detektimit te zjarrit

Kontraktori duhet te instaloje nje sistem dedektimi te zjarrit.

Sistemi perbehet nga dedektore manuale dhe dedektore automatike te tymit dhe nxehtesise.

Ne raste zjarri dhe difekti cdo zone sinjalizon vecmas te centrali qe ndodhet ne dhomen e sigurise ne katin perdhe. Sistemi qendror sinjalizon rastet ne meyre optike dhe akustike.

Duhet te jete e mundur qe cdo zone te ckycet vecmas.

Sistemi i dedektimit te zjarrit do te paiset me nje funksion per nderhyrje, kjo do te thote qe perdoruesi mund te nderprese per nje kohe te shkurter fillimin e alarmit ne te gjithe ndertesën.

Pas voneses se kohes se nderhyrjes sistemi leshon alarmin, fillojne pastaj sirenat ne te gjithe ndertesën.

Aktivizimi i dedektorit manual qe ndodhet prane stacionit qendror te sinjalizimit te zjarrit shkakton menjehere alarm nga sirenat. Kabllot per dedektoret do te supervizohen automatikisht per ndonje qark te shkurter dhe shkeputje. Cdo anomali do te sinjalizohet. Ngjyra e kablllove te dedektorit duhet te jete e Kuqe dhe e ndare nga cdo instalim tjeter i shtrire ne tuba.

Sistemi i dedektimit te zjarrit eshte i paisur me nje bateri per autonomi per 24 ore per nje funksionim te plote per te gjithe sistemin (24 ore sistem i dedektimit te zjarrit dhe 1 ore alarm).

Sistemi qendror duhet te jete, ne menyre opzionale, i zgjerueshem per te gjithe ndertesën.

Detektoret do te lidhen me kablllo sipas fabrikatit te cilat do te instalohen vecmas nga te gjitha instalimet e tjera ne tuba ose kanalina.

Kabllot per paisjet e alarmit duhet te jene rezistente ndaj zjarrit per 90 minuta, komponentet e suportit te kablllove (morsetat) duhet te jene rezistente ndaj zjarrit per te njejten kohe ose kabllot duhet te vendoset minimumi 2 cm nen suva (per shembull instalim vertikal te murin e shkallve ose ne puseta). Nuk lejohet qe te instalohen sisteme suporte kablllosh, komponente, paisje kablllosh e me radhe, te cilat kane nje rezistence me te vogel ndaj zjarrit se vete kabllot.

Nese kabllot rezistente ndaj zjarrit do te instalohen vertikalisht ne mur, kabllloja duhet te shtrihet cdo 3m ne forme laku (mase mbrojtese ndaj rreshqitjes se kablllos).

Pershkrimi i produkteve

Detektori optik i tymit i adresueshme

Ne saje te aftesise se tij te larte te perpunimit, eshte ne gjendje te analizoje ne menyre eficiente gjendjen e zones se mbrojtur, duke garantuar imunitet te larte ndaj alarmeve terreme.



- Tensioni i furnizimit: 17V to 30V DC
- Rryma nominale: 450 uA max.
- Rryma ne gjendje alarmi: 4mA
- Ndjeshmeria: Ne perputhje me standartin EN54-5 dhe EN54-7
- Madhesia e kabllit per morseten: 0.5-2.5mm²
- Koha e risetimt: 20sek. max
- Temperatura e operimit: -10 - 50°C

Detektori i temperatures i adresueshme

Ky detektor kontrollon temperaturen e ambientit, me te cilin eshte pajisur. Ne saje te algoritmit te analizimit te implementuar ne brendesi te tij, garanton pergjigje eficiente dhe imunitet te larte ndaj alarmeve te rreme. Nepermjet programatorit, mund te pershtatet si detektor termik, me prag te fiksuar ose ne temperature te larte.



- Tensioni i furnizimit: 17V to 30V DC
- Rryma nominale: 450 uA max.
- Rryma ne gjendje alarmi: 4mA
- Ndjeshmeria: Ne perputhje me standartin EN54-5 dhe EN54-7
- Madhesia e kabllit per morseten: 0.5-2.5mm²
- Kufiri e veprimit: 55/65/75/85°C
- Koha e risetimt: 20sek. max
- Temperatura e operimit: -10 - 50°C/-10 - 85°C
- I paisur me llampushke sinjalizuese

Sinjalizuesi optik/akustik

I adresueshem per konsum te ulet, i pershtatur per te gjitha centralet analoge te adresueshemte detektimit te zjarrit, me ushqim direkt nga loop. Duhet te instalohet ne cdo hapsire te brendshme ku ka edhe pulsant manual, gjithashtu edhe jashta referuar projektit. Fuqia e emetimit te tingullit, e rregullueshme, deri ne 100dB



- *Tensioni i ushqimit: Nga qarku 20 V deri ne 30 V DC*
- *Rryma nominale ne alarm: 0.5mA*
- *Temperatura e operimit: -10°C to 50°C*
- *Shkalle mbrojtje: IP44, tipi A*

Pulsanti i alarmit

Pulsanti i alarmit lidhet ne menyre direkte me loop e detektimit te centraleve analogete adresueshem. Duke shtypur ne pjesen e aktivizimit (qe tregohet qarte sipas pershkrimevete Normes EN54-11), mekanizmi i thjeshte, por i mprehte riprodhon efektin e caktuar ngathyerja e nje xhami, pulsanti mund te perpunohet thjeshtesisht duke duke perdorur çelesin plastik ne aparature.

Ky tip pulsanti eshte ideal per te gjitha ato aplikacione subjekte te aktivacioneve te rremefrekuente (shkolla, qendra tregtare dhe vende te tjera publike).

Ngjyra e kuqe



- *Tensioni i ushqimit: Nga qarku 20 V deri ne 30 V DC*
- *Rryma nominale ne alarm: 3.1mA*
- *Temperatura e operimit: -10°C to 50°C*
- *Shkalle mbrojtje: IP24D*
- *i paisur me celes per rikthimin ne gjendje normale*

Indikatori ne distance

Perserites optik me LED qe tegon ne distace qe sensori brenda tavanit eshte ne alarm. Ky sensor komunikon vetem me sensorin brenda tavanit.



- Tensioni i ushqimit: Nga qarku 3.3 V deri ne 10 V DC
- Rryma nominale ne alarm: 7mA
- Temperatura e operimit: -10°C to 50°C

Paneli distant i kontrollit dhe vizualizimit me ekran LCD

Eshte nje tastiere opsionale e pajisur me LED, taste dhe ekran qe replikon te gjitha funksionete panelit frontal te centralit. Lokalizohet ne pikat ku eshte i nevojshem ofrimi i mundesise sekondit dhe vizualizimit. Çdo central SmartLoop administron deri ne 8 perserites, te cilet mund te lidhen ne nje distance maksimale prej 1000 m nga centrali. Lidhja me centralin realizohet nepermjet busit RS485, gjithmone te pranishem ne skeden kryesore te centraleve.

Central me 2 loop, te zgjerueshem me 8, i pajisur me panelin e komandimit me ekran LCD.



- *Nr i qarqeve: 2 loops - Max 275 mA per loop*
- *Dalje sirene: 2 me 28 V DC / 500 mA secila*
- *Dalje rele ne rast zjarri : 2 me 50 VAC / DC 1A*
- *Dalje rele ne alarm: 1 me 50 VAC / DC 1A*
- *Konsumi vetjak: 65W, 130mA per qark.*
- *Temperatura e operimit: -10°C to 50°C*
- *Shkalla e mbrojtjes: IP21*
- *I paisur me bateri emergjense 12V 7Ah*
- *Kapaciteti i qarkut: 125 paisje max.*
- *Gjuhet: i paisur me disa gjuhe*
- *Programimi: mundesi programimi ne tastiere dhe me PC*
- *Certifikimi: EN54-2 dhe EN54-4*

Logjika e funksionimit te sistemit Loop

Para se te filloje instalimi, daljet e planifikuara dhe kerkesa te vecanta duhet te koordinohen me gjendjen ne fakt. Loop nuk duhet te kaloje me shume se 120 paisje. Ai fillon ne central dhe mbyllet ne central. Kabell alarm zjarri 2x1mm² duhet te perdoret i shtrire ne tub plastik fleksibel. Specifikimet e kabllit jane si meposhte:



Kabell alarm zjarri

120 minuta rezistent ndaj zjarrit, i mbrojtura (lloji SF), dhe i pambrojtur (lloji RF). Kabell për sistemimin e përhershëm të zjarrit. Shkarkim të paket të halogenit, emetim të ulët të tymit dhe gazrave toksike dhe retardantëve të flakës. I përshtatshëm për instalimet e brendshme në hapësirat publike, edhe në lagësht dhe në natyrë (jo për mjedise të vështira). Mundesi instalimi me kablllo të energjisë elektrike është e lejuar për 450 / 750V dhe 0.6 / 1kV.

1.10 Sistemi i tokezimit dhe i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike


Sistemi i tokezimit dhe i rrufepritesit do te behet sipas vizatimeve.

Arsyet kryesore për tokëzimin dhe lidhjen në instalimet elektrike janë:

- Për të eliminuar mundësinë e goditjes elektrike të personelit.

- Për të lejuar pajisjet mbrojtëse të funksionojnë në mënyrë të saktë në mënyrë që kohëzgjatja e rrymave të defekteve (lidhjeve të shkurtra) të mbahen në minimum
- Për të barazuar potencialin e tensionit të punimeve metalike normalisht jo-aktuale
- Për të parandaluar ngarkimin elektrostatik të centralit të procesit në lëvizjen e lëngjeve.

Duke qenë se është perzgjedhur skema e furnizimit TN-C sipas standartit IEC 60364, mqs në objekt nuk kemi paisje për mundësi ndezje zjarri apo deformim të fushet magnetike atëherë menyra e tokezimit dhe e furnizimit do të jetë sipas figures se mëposhtme:



Skema TN-C

Sistemi i tokezimit duhet të jetë me shumë se 5 metra nga sistemi i rrufepritesit. Në rast se vlerat e rezistencave nuk arrijnë vlerën e shënuar në vizatim atëherë duhet të rritet numri i elektrodave të tokezimit. Mos të realizohet sistemi ku ka kimikate apo materiale të tjera që ndryshkun materialet e tokezimit. Sistemi i tokezimit duhet të jetë 50cm nën sipërfaqe. Në hyrje të objektit të vendoset një pusëse ku të jep mundësinë për të bërë kontrollin e rezistencës së tokezimit. Të gjithë panelet duhet të kenë zbarë tokezimi. Në kabinën elektrike duhet të instalohet rrjeti ekuipotencial, një përcjelles Cu 70mm² i cili vendoset 40cm nga sipërfaqja. Pjesë e këtij përcjellesi është edhe zbara ekuipotenciale si në figurë ku në të lidhen të gjithë përcjellesit e tokezimit që lidhen me paisjet. Paisjet brenda kabines nuk duhet të tokezohen me përcjelles me të vogël se 70mm², Cdo pjesë metalike në kabine duhet të tokezohet. Duhet të tokezohet, transformatori, celat, paneli TU, neutri i transformatorit. Rezistenca e tokezimit mbrojtës nuk duhet të jetë me shumë se 4ohm.

Në objekt duhet që cdo panel të ketë zbarë të tokezimit. Secili nga panelet duhet të marrë tokezimin nga zbara kryesore në panelin kryesor të godinës. Cdo kanaline me talike duhet të ketë tokezimin, dhe kanalinat me njëra tjetren duhet të lidhen me përcjelles tokezimi duke shfrytëzuar bulonerite e bashkimit të tyre.

Të gjithë paisjet që kanë furnizim me kabell ushqimime të mëdha se 35mm² duhet të tokezohen me përcjelles 70mm². Ndërsa paisjet e tjera me përcjelles 25mm² ose 16mm².

Rrufepritesi

Për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike do të përdoren: a) sistemi i rrufepritesit në formë rrjete dhe me shtiza b) Shkarkuesi i mbitensionit në panelin kryesor.

Duke qene qe objekti ka perqendrim te madh te njerzve atehere duke ju referuar standartit EC 60364 do te behet mbrojtje e klasit 1 ku, kuadrati i rrjetes nuk duhet te kaloje siper 25m^2 dhe me rezistence tokezimi jo me te madhe se 10ohm .

Per sistemin e rrufepritesit eshte parashikuar mbrojtja ne forme rrjete dhe me shtiza pasi objekti ka pjese te dalura. Kuadratet e rrjetes duhet tekene dimensione $4\times 6\text{ml}$, te realizuar me shirit zinku $Zn= 30\times 3\text{mm}$ i cili mbeshtetet mbi suporta betoni. Nje kontur me shirit zinku $Zn= 30\times 3\text{mm}$ duhet te shtrihet perreth objektit i cili lidhet me elektrodas e tokezimit si ne vizatim. elektrodas instalohen brenda pusetes. Per secilen nga zbritjet duhet te vendoset shkeputesi per matje. Rezistenca e tokezimit nuk duhet te jete me shume se 10ohm .

Per cdo zbritje te rrufepritesit duhet te vendosen shkeputes per matje dhe brenda pusetave te vendoset elektroda e tokezimit.

Materialet qe duhet te perdoren duht te jene sipas standartit CEI EN 61936-1, CEI EN 50522 e CEI 64-8 dhe sipas specifikimeve te meposhteme:



Elektrode tokezimi

- *Materiali: celik i galvanizuar*
- *Dimesionet $L=1500, 50\times 5\times 5$*



Zbare ekuipotenciale

- *Morsetat: 5 x 35 mm² 3 x 50 mm² 1 x 120 mm*
- *Materiali: Baker dhe e paisur me suport plastik.*



Shkeputes per matje


- *Bazament baker*
- *Suport plastik*
- *Bazament zinku*



Shkeputes per matje

- *Materiali: Celik i galvanizuar*
- *E paisur me dy vrima 10mm per montim*

- *Diametri 16mm*



Shirit zinku 30x3mm

- *Materiali: Celik i galvanizuar*
- *Densiteti i zingimit: 500g/m²*
- *Densiteti: 0.75kg/ml*



Percjelles Cu 70mm²

- *Materiali: Baker*
- *Densiteti: 0.625kg/ml*

SHËNIME TEKNIKE

Për zbatimin e Sistemit Hidrosanitar, Furnizimi me Ujë

- Projektimi i Sistemit Hidrosanitar të Furnizimit me ujë të ndërtesës është kryer në bazë projektit arkitektonik të dhënë.
- Për çdo ndryshim të projektit të Sistemit të Furnizimit me ujë të ndërtesës dhe për çdo problem gjatë zbatimit të kontaktohet paraprakisht me projektuesin e Sistemit Hidrosanitar të Ndërtesës.

FURNIZIMI ME UJË

- Instalimet H/sanitare të kryhen në përputhje me kushtet teknike të zbatimit në fuqi.
- Rrjeti i furnizimit të instalohet me tuba polipropileni me PN 10 për furnizimin me ujë të ftohtë dhe me tuba polipropileni PN20 për ujin e ngrohtë sanitar.
- Llogaritjet e këtij rrjeti janë kryer duke marrë parasysh përdorimin e grupeve mishelatorë në aparatet sanitare, si më poshtë:
 - Merret në konsideratë numri i aparaturave duke filluar nga kati i sipërm e deri tek pika e lidhjes për çdo pjesë llogaritëse të rrjeti.
 - Për çdo pjesë të rrjetit dhe bazuar edhe në ekuivalentët e çdo aparature, nxirren ekuivalentët e çdo pjese llogaritëse. Më pas në bazë të tabelave $Q = f(\sum S)$, ku S – ekuivalentët, nxirren prurjet llogaritëse, për çdo pjesë llogaritëse të sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë. Më pas bazuar edhe në shpejtësitë e rekomanduar $V = 0.90 - 1.5$ m/sek për çdo pjesë llogaritëse, përmasohen elementët e sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë. Nga Grafikët nxjerrim humbjet njësi për çdo pjesë llogaritëse dhe nga formula $h_w = i \times L$, nxjerrim humbjet për çdo pjesë.
 - Në sa thamë më sipër, nxjerrim parametrat hidraulikë të sistemit (prurja e kërkuar dhe presioni në pikën e lidhjes):

$$Q = 1.87 \text{ l/sek}$$

$$H = 50 \text{ m,}$$

për largësi nga ndërtesa jo më shumë se 10 m. Për largësi më të mëdha duhet presion më i madh në pikën e lidhjes (i cili do të përcaktohet në varësi të largësisë së pikës së lidhjes nga ndërtesa)

Per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem dhe pa nderprerje me uje do te vendosen depozita per te grumbulluar sasine e nevojshme te ujit edhe ne momentet kur ujesjellesi nuk percjell uje ne rrjet. Llogaritja e kapacitetit te nevojshem do te behet duke shumezuar normen ditore 250 l/dite/banor.

Tabelat e prurjeve dhe të ekuivalentëve në bazë të të cilave kryhen llogaritjet për sistemin hidrosanitar të furnizimit me ujë të pijshëm, jepen më poshtë:

Prurjet e çdo pajisjeje hidrosanitare

Emërtimi i Pajisejeve Hidrosanitare	Uji i Ftohtë [l/sek]		Uji i Ngrohtë [l/sek]		Presioni [m]
Larëse Duarsh	0.10		0.10		5
Bide	0.10		0.10		5
Klozetë me kasetë (WC)	0.10		-		5
Vaskë Banjoje	0.20		0.20		5
Grup Dushi	0.15		0.15		5
Larëse Pjatash (Lavapjatë)	0.20		0.20		5
Larëse Automatike rrobash (Lavatriçe)	0.15		-		5
Larëse Automatike Enësh (Lavastovilje)	0.15		-		5

Ekuivalentët e Prurjeve të Ujit të Pajisjeve

Emërtimi i Pajisejeve Hidrosanitare	Uji i Ftohtë [ek]		Uji i Ngrohtë [ek]		Totali [ek]		Presioni [m]
Larëse Duarsh	0.75		0.75		1.00		5
Bide	0.75		0.75		1.00		5
Klozetë me kasetë (WC)	3.00		-		3.00		5
Vaskë Banjoje	1.50		1.50		2.00		5
Grup Dushi	1.50		1.50		2.00		5
Larëse Pjatash (Lavapjatë)	1.50		1.50		2.00		5
Larëse Automatike rrobash (Lavatriçe)	2.00		-		2.00		5
Larëse Automatike Enësh (Lavastovilje)	2.00		-		2.00		5

- Diametrat e tubacioneve horizontale të shtruara në dyshemetë e mjediseve të ndërtesës apo muret e nyjeve sanitare, jepen në planimetrinë e ndërtesës dhe të çdo nyjeje sanitare.
- Aparati Ujëmatës (kontatori) do të vendoset në kutinë përkatëse, përmasa e së cilës të mundësojë futjen brenda saj të kontatorit, saraçineskës dhe kundraavalvolës së parashikuar.
- Para mbulimit të tubacioneve të kryhet prova hidraulike e rrjetit të brendshëm të ujësjellësit duke marrë masat sipas kushteve teknike, me presionin e ujit 9 – 10 bar, për një periudhë kohore jo më pak se 24 orë. Rënia e presionit të jetë më pak se 0.1 bar / orë.

Më poshtë po japim një pamje të grupit të presionit për objektin e mësipërm.

SHËNIME TEKNIKE

Për zbatimin e Sistemit Hidrosanitar, shkarkimit të ujërave të përdorura

Projektimi i Sistemit Hidrosanitar të Shkarkimit të Ujërave të Përdorura të Ndërtesës është kryer në bazë projektit arkitektonik të dhënë.

- Për çdo ndryshim të projektit të Sistemit të Shkarkimeve të Ujërave të përdorura të ndërtesës dhe për çdo problem gjatë zbatimit të kontaktohet paraprakisht me projektuesin e Sistemit Hidrosanitar të Ndërtesës.
- Instalimet H/sanitare të kryhen në përputhje me kushtet teknike të zbatimit në fuqi.
- Llogaritjet e tubacioneve të lidhjes së aparaturave dhe të dërgimit në banja janë llogaritur me anën e vlerave të ekuivalentëve të shkarkimit, me vlerat si më poshtë:

Emërtimi i Pajisjes Hidrosanitare	Njësitë e Shkarkimit (Ekuivalentët)		Diametri i Tubacioneve (mm)
Larëse Duarsh	0.50		50
Bide	0.50		50
Klozetë me kasetë (WC)	2.50		110
Vaskë Banjoje	1.00		50
Grup Dushi	0.80		50
Larëse Pjash (Lavapjatë)	1.00		50
Larëse Automatike rrobash (Lavatriçe)	1.00		50
Larëse Automatike Enësh (Lavastovilje)	1.00		50

Nga tabelat përkatëse dalin diametrat e kolonave të shkarkimit dhe të tubacioneve të derdhjes së ujërave nën dyshtim të ndërtesës.

- Tubat e kolonave dhe të dërgimit në banja dhe të linjave të derdhjes së ujit nën dyshtemenë e ndërtesës, **TË JENË** tuba Polipropileni (PP) ngjyrë gri me izolim me gomina PN6 (me spesor të trashë).
 - Diametrat e kolonave të shkarkimit janë dia. 110 mm (PP)
 - Diametrat e tubave horizontalë të dërgimit në banja, në dyshteme të jenë me dia. 50 mm dhe me pjerrësi 2 %.
 - Diametrat e tubave të derdhjes nën dyshtemenë e ndërtesës, janë me dia. 110 mm, ose me dia. 125 mm, siç jepen në planimetrinë e ndërtesës dhe të vendosen me pjerrësi 2 %.
 - Diametrat e kanalizimit të jashtëm janë me dia. 160 mm kur përcjellin vetëm ujrat e përdorura dhe me dia. 250 mm, kur përcjellin edhe ujrat e shiut nga tarraca e objektit, dhe vendosen me pjerrësi 2 %.
 - Pjerrësia e tubacioneve të jetë konstante gjatë gjithë traktit.
 - Të kontrollohet vertikiliteti i kolonave të shkarkimit.
 - Lidhjet e kolonave me tubat e derdhjes së ujit nën dyshtemenë e vilës (kthesë me kënd 90°), të realizohet me dy bërryla 45°.
 - Çdo ndryshim vertikaliteti i aksit të kolonave të realizohet me bërryla 45°.
 - Lidhja e tubave të dërgimit në dyshteme të realizohet me braga dhe bërryla me kënd 45°.
 - Para futjes së kolonave të shkarkimit nën dyshteme, të vendosen pjesë pastrimi siç tregohet në fletët e vizatimeve.
 - Lidhja e tubave në mur me fasheta me diametrat përkatëse të realizohet si më poshtë :
 - Kolonat vertikale çdo 1.50 m dhe nën çdo bragë apo bërryl.
 - Vrimat në muret perimetralë të izolojnë me suargjilë ose material tjetër izolues elastik (kur janë nën tokë).
 - Sifonet e aparateve sanitare të jenë minimalisht me lartësi 100 – 150 mm.
 - Të kryhet kontrolli për mosrrjedhjen e ujit në tuba, duke i mbushur tubacionet me ujë dhe me presion 2 - 3 m kolonë uji.
 - Pusetat të realizohen prej betoni hidroteknik, me mur me trashësi 20 cm. Nga brenda të vishet me llaç, për mbrojtjen e betonit nga agresiviteti i ujrave të përdorura, si dhe të sigurohen për të mos lejuar filtrimin e ujrave të përdorura nga puseta. Pusetat të vendosen në distancë 3.00 m nga faqja e murit.

- Të sigurohen lidhjet e tubave të derdhjes dhe ato të rrjetit të oborrit, për të mos lejuar filtrimin e ujrave të përdorura nga to. Po kështu edhe lidhja e tubave me pusetën të sigurohet për të mos lejuar filtrimin e ujrave.

BASHKIA BERAT

BERAT, 2020

2020

[RELACION HVAC]

**PRISHJA E SHKOLLES
BABE DUDE
KARBUNARADHE
NDERTIMII NJE OBJEKTI
TE RI Berat , Shqiperi**

Ark:	Lucjano Bojaxhiu
Ark:	Ergis Senka
Ark. Rest.:	Arben Spaho
Inxhinier:	Rolinda Veliu
Ing.Hidro:	Mirel Mico
Ing.Gjeodet:	Anxhelo Dhima
Ing.Gjeodet:	Deni Zlyftari
Ing.Elektrik:	Fatmir Ndreka
Ing.Elektrik:	Elisa Reci

SISTEMI I NGROHJES

I. Kushtet e projektit

Konditat e komfortit termoigrometrik (mireqenia fiziologjike) qe mund te sigurojme brenda pallatit jane ne vartesi te destinacionin te perdorimit te ambienteve. Te dhenat e meposhteme jane perdorur si referenca per projektin.

Lloji i punimit	Instalimi i rrjetit te ngrohjes
Adresa	Berat, Bulevardi Republika
Destinacioni i perdorimt	Gjimnaz
Lloji i impiantit	Kaldaje

Sistemi i ngrohjes se godines eshte planifikuar te jete me kaldaje me pelet. Burimi i energjise do te sigurohet nga kaldaja. Uji i ngrohje do te shperndahet nga rrjeti i tubove te cilet vijne nga ambienti teknik dhe nepermjet kolonave vertikale bejne te mundur shpernarjen ne cdo kate. Ne hyrje te cdo kati eshte vendosur nga nje kolektor nepermjet te filit beher furnizimi I cdo grupi radiatoresh. II. Grupet termike Kerkesat per ngrohje e objektit jane kalkuluar ne baze te standarteve qe jane fuqi ne Shqiperi. Temperatura e ambientit te jashtem eshte perzgjedhur $+1^{\circ}\text{C}$. Kapaciteti i kaldajes perballon energjine e nevojshem per ngrohjen individuale te cdo mjedisi.

II. Grupet termike

Kerkesat per ngrohje e objektit jane kalkuluar ne baze te standarteve qe jane fuqi ne Shqiperi. Temperatura e ambientit te jashtem eshte perzgjedhur $+1^{\circ}\text{C}$. Kapaciteti i kaldajes perballon energjine e nevojshem per ngrohjen individuale te cdo mjedisi.

RELACION TEKNIK

Relacion I mbrojtjes nga zjarri

Rindertim Shkolla “Babe Dude Karbunara”

Ark:	Lucjano Bojaxhiu
Ark:	Gjergj Dushniku
Inxhinier:	Vali Zotkaj
Ing.Hidro:	Florian Tumani
Ing.Gjeodet:	Anxhelo Dhima
Ing.Elektrik:	Fatmir Ndreka
Ing.Elektrik:	Elisa Reci
Ing.Elektrik:	Arjan Coka
Inxhinier:	Lefter Ndrio

Permbajtje

1	QËLLIMI	3
2	SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI.....	3
2.1	Hyrje.....	3
2.2	Klasifikimi i zjarreve	3
2.3	Substancat shuarese te zjarrit	4
2.4	Pajisjet e shuarjes se zjarrit.....	4
3	PROJEKTIMI.....	4
3.1	Kritere te pergjithshme projektuese	4
3.2	Faktoret percaktues.....	5
3.3	Karakteristika te materialeve ndertimore.....	5
3.4	Furnizimi me uje i sistemit te mbrojtjes nga zjarri	5
3.5	Burimi i furnizimit me uje	5
3.6	Sasia e ujit te kerkuar	5
3.7	Rezervuaret e ujit.....	6
3.8	Tubacionet e shperndarjes dhe lidhjet	7
3.9	Hidrantet dhe fikset e zjarrit	11
3.10	Impiantet antizjarr.....	12
3.11	Tubat e hidrantit.....	13
3.12	Fikset e zjarrit	15
3.13	Ndricim i emergjences.....	17
3.14	Impiantet antizjarr.....	17
3.15	Rrufepritesit	17
3.16	Evakuimi I banoreve.....	17
4	PAJISJET QE PERDOREN.....	18
4.1	Qellimi	18
4.2	Sipërfaqet e ekspozuara.....	18
4.3	Instalimet	18
4.4	Sensor alarm zjarri	18
4.5	Sinjalistika.....	20
4.6	Sinjalizuesit e tymit të duhanit	22
4.7	Zjarrpërgjuesit automatik	22
4.8	Pajisjet e sinjalizimit	22
4.9	Sistemi i tokëzimit.....	22
4.10	Sistemi i mbrojtjes atmosferike	23
4.11	Zilet e alarmit	24

1 OËLLIMI

Rregullat teknike te projektimit dhe zbatimit te objektit kanë për qëllim të përcaktojnë masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në ndërtesat e destinuara për banim.

2 SISTEMI I MBROJTJES NGA ZJARRI

2.1 Hyrje

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit eshte projektuar per te perballuar ne dy forma situataten emergjente per shuarjen e zjarrit.

Mbrojtja aktive :

Ka te beje me instalimin e dispozitivave shuares sikurse hidrantet e brendshem dhe te jashtem, fikset me shkume pluhur e gas, sprinklerat, detektorete tymit, flakes etj.

Mbrojtja pasive :

Ka te beje me materialet e strukturave te ndertesese, te cilat vleresohen ne baze te rezistences qe paraqisin karshi zjarrit, seksionet e ndarjeve, sistemin e daljeve te emergjences, ventilimit te tymrave etj.

Ne kete seksion do te trajtohet vetem pjesa aktive e sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit pa pjesen e dedektimit dhe nderhyrjes automatike.

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit do te realizohet ne baze te:

Dimensioneve, specifikimeve dhe kualitetit te materialeve te percaktuar ne vizatim, instruksioneve te inxhinierit perfaqesues, standarteve dhe normave lokale si dhe ato te vendeve te Komunitetit European.

Sistemi i mbrojtjes kunder zjarrit respekton te gjitha kerkesat e detyrueshme shteterore qe kane te bejne me normat / standartet qe jane ne fuqi aktualisht ne Shqiperi si dhe normat italiane CNVVF/CPAI UNI 9485.

Gjate procesit te disenjimit dhe aplikimit te sistemit eshte mire qe te kontaktohet me autoritetet vendore te MNPZSH per te siguruar nje testim dhe aprovim te ketij instalimi.

2.2 Klasifikimi i zjarreve

Per te perdorur agjente shuares te pershtatshem gjate procesit te mbrojtjes nga zjarri, ne funksion te materiave qe mund te marrin flake, duhet te merren patjeter ne konsiderate klasa e zjarrit.

Ne baze te normave / standarteve bashkekohore, pajisjet shuarese te zjarrit jane klasifikuar ne pese klasa.

Standarti europian DIN EN per keta shuarsa dallon klasat e meposhtme:

Klasa A Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te ngurte sikurse derrase, leter, plastik, tekstile, etj.

Klasa B Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te lengshem sikurse benzene, benzole, nafte, alkol, vajra etj.

Klasa C Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve te gazte sikurse metan, propan, butan GPL etj.

Klasa D Perdoret per zjarre qe e kane origjinen prej materialeve metalike sikurse alumin, magnesium, sodium, etc.

Klasa E Perdoret per pajisje elektrike qe jane nen tension.

Ne vizatime jane percaktuar me saktesi edhe zonat qe kane lidhje me klasat e zjarrit si dhe vendet ku jane vendosur hidrantet si dhe fikset e zjarrit.

2.3 Substancat shuarese te zjarrit

Duke marre ne konsiderate karakteristikat e nderteses si dhe aktivitetet qe zhvillohen, do te perdoren substanca shuarese si me poshte:

- Uje:(zyra, ambjente banimi, ambiente te perbashketa etj)
- Shkume:(zyrat, ambjentet e sherbimit)

2.4 Pajisjet e shuarjes se zjarrit

Tipet e fiksuar

- Hidrante ne brendesi te godines(aplikohen)
- Hidrante jashte godines (aplikohen)
- Sisteme me sprinkler (nuk jane aplikuar)

Tipe te levizshem (cilindra karelato shkume, pluhur), (aplikohen).

3 PROJEKTIMI

3.1 Kritere te pergjithshme projektuese

Eshte konceptuar qe te projektohet ne perputhje me kerkesat dhe normat e pajisjeve shuarse qe do te aplikohen. Duke konsideruar qe hidrantet zene pjesen me te madhe ne sistemin kunder zjarrit, ai analizohet ne menyre te vecante duke selektuar njekohesisht edhe tipologjine tij.

Efikasiteti i sistemit te mbrojtjes kunder zjarrit pa anashkaluar aftesine e operatoreve, do te varet ne nje shkalle te larte nga mjaftueshmeria e kapacitetit te ujit dhe presionit te tij, te cilet duhet te jene te mjaftueshem per te shperndare ne lançe sasine e nevojshme te ujit si dhe te kene mundesine e kontrollit dhe te shuarjes ne kohen e duhur nje zjarr te mundshem

3.2 Faktoret percaktues.

Faktoret percaktues qe duhen marre ne konsiderate gjate projektimit duhet te jene :

- Natyra dhe permasa e zjarrit;
- Madhesia e zones qe do te mbrohet;
- Mundesia e perhapjes me shpejtesi e zjarrit;
- Kerkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato qe jane ne fuqi ne Shqiperi.

3.3 Karakteristika te materialeve ndertimore:

Kur një element në çelik, i përforcuar me cemento te armuar normale ose presuar , nuk është i mbrojtur dhe i ekspozuar ndaj temperaturave të larta humbet aftësinë e tij për t'i bërë ballë qellimit për të cilën është projektuar. Në mënyrë që të vonojë rënies së element,dhe si pasojë e gjithë struktura, duhet të ketë një sistem të mbrojtjes nga zjarri pasive, e cila e rrit "rezistencen ndaj zjarrit" te elementeve strukture (trarëve, kolona, tavane, etj.) Dhe zgjasin kapacitetin duke mbajtur për një periudhë të caktuar kohore të nevojshme për të shuar zjarrin dhe të evakuojnë zonën. Performancën dhe cilësinë e një materiali për mbrojtjen pasive e strukturave janë jetike kur është fjala për zgjedhjen dhe zbatimin.

3.4 Furnizimi me uje i sistemit te mbrojtjes nga zjarri

Pajisjet e shuarjes se zjarrit duhet te disponojne sasine complete te ujit te nevojshem per luftuar zjarrin ne momentin kur ai shfaqet. Kjo do te realizohet nepermjet instalimit te hidranteve te ujit brenda dhe jashte nderteses. Këto nga ana e tyre duhet te furnizohen me sasinë e duhur te ujit si dhe presionin e mjaftueshëm.

3.5 Burimi i furnizimit me uje

Furnizimi me uje konsiston ne nje nga kombinimet e meposhtem:

- Lidhja me rrjetin e ujit te qytetit;
- Rezervuaret vertikale te lidhur me nje pompe me seksion te pershtatshem per furnizim.

3.6 Sasia e ujit te kerkuar

Kerkesat per depozitim te ujit per mbrojtje kunder zjarrit jane bazuar ne konsiderimin qe ne nje kohe te mundshme mund te perballemi me rrezikun e çfaqjes se zjarrit. Sasia e ujit qe kerkohet eshte barabarte me kerkesat per uje te vazhdueshem per shuarjen e zjarrit si dhe kohen ne dispozicion qe duhet per eliminimin e tij. Kjo sasi perzanton realisht depoziten e nevojshem ne dispozicion per mbrojtjen nga zjarri.

Ne rastin tone konkret ku janë marre në konsideratë aktivitetet që kryen në godinë, lëndet dhe materialet e depozituar, referenca i përket zonave me ngarkesë zjarri të moderuar. Në këtë rast sistemi duhet të posedojë karakteristika të tilla:

Pra duhet garantuar një sasi uji që të furnizojë hidrantet (tipi Kasete) që ndodhen në një pozicion hidraulik me të sfavorizuar me sasi uji minimale prej 120 l/min për rastin e një kolone vertikale dhe me dy ose me shumë kolona duhen të furnizojnë minimalisht 2 hidrant për kolonë, me presion në dalje prej 1.5 deri në 2 bar dhe një kohë zgjatje prej 60 min.

- Presioni min / max: 2 / 4.5

(bazuar në formulën Hazen Williams, presion 10m, humbje 10 m, presion pune 20 m)

- Zona e mbrojtur $\leq 200 \text{ m}^2$
- Autonomia $\geq 60 \text{ min}$

3.7 Rezervuaret e ujit

Depozitat e ujit do të jete në formën e rezervuareve vertikale mbi tokë dhe që duhet të jene në përputhje me dimensionet dhe përcaktimet të bërë në vizatim, duke përfshirë lidhjet, menyrën e furnizimit me ujë, tubacionet lidhëse, kapërderdhjen, galexhantet mekanik etj, si dhe të gjitha kërkesat për të siguruar një funksionim normal.

Rezervuaret e mesiperm duhet të sigurojnë sasine e nevojshme të ujit sipas përcaktimeve të mesiperm. Volumi i tyre si dhe specifikimet teknike të tjera janë prezantuar në vizatimet përkatëse.

Për mbrojtjen kundër zjarrit janë parashikuar vendosja e dy të cilat do të furnizojnë hidrantet e vendosur në çdo kat në afërsi të shkallëve nepermjet dy kolonave vertikaleve.

Materiali i rezervuarve duhet të jete prej çeliku të zinguar ose prej çeliku inoks. Forma e tyre do të jete cilindrike vertikale. Kjo formë varet nga vendi i instalimit dhe kërkesave në projekt. Kalkulimi i trashësisë së materialit të rezervuarit do të dipendohet nga vëllimi i rezervuarit si dhe forma por kjo trashësi nuk duhet të jete më pak se 1.5 mm.

- Rezervuari i ujit do të kompozohet si më poshtë:
- Tubacionet e furnizimit me ujë, në këto tuba do të vendosen valvola moskthimi;
